



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 67 datë 01.08 2025

PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI I PËRMETIT"

DR .GENTIAN TOSHKËZI

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 pika "m" dhe neni 55 e në vijim, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", nenet 8 e në vijim; VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetares së Bashkisë Përmet,

V E N D O S I:

1. T'i jepet Dr.Gentian Toshkëzi MD FAANS titulli "Qytetar Nderi i Përmetit", me motivacionin:

"Atdhetar për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në fushën e shkencës dhe mjekësisë, për përfaqësimin me dinjitet të vlerave shqiptare, në botë, dhe për lidhjet e vazhdueshme shpirtërore e njerëzore me vendlindjen e të parëve të tij – Përmetin.

Dr. Toshkezi është një shembull frymëzues i suksesit dhe përkushtimit për brezat e rinj përmetarë dhe shqiptarë kudo në botë. Me punën dhe arritjet e tij, ai ka kontribuar jo vetëm në zhvillimin e neurokirurgjisë moderne, por edhe në promovimin e emrit të Shqipërisë dhe Përmetit në rrethet më të larta të shkencës dhe diplomacisë"

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI